


TË RINJTË NË POLITIKË



TË RINJTË NË POLITIKË

Ky artikull është mbështetur nga:

Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe nga Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe i menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).

Dhe

Ambasada e Mbretërisë së Norvegjisë



Norwegian Embassy

Deklaratë mohimi: Pikëpamjet dhe analizat në këtë artikull janë vetëm të Grupit për Ballkan dhe nuk reflektojnë qëndrimet e donatorëve.

Autor: Grupi për Hulumtime të Politikave në Ballkan (BPRG)

TË RINJTË NË POLITIKË

Demokracia nuk është e plotë pa gjithëpërfshirje; të rinjtë dhe gratë duhet të jenë pjesë e rëndësishme e vendimarrjes. Të rinjtë në Kosovë konsiderohen burim i fuqisë politike. Ata përbëjnë më shumë se gjysmën e popullsisë dhe janë pjesë e konsiderueshme e elektoratit. Megjithëkëtë, përfshirja e tyre në vendimarrje dhe planifikim të politikave mbetet shumë e kufizuar. Politika vazhdon të konsiderohet një sferë ekskluzive për burra të fuqishëm dhe me përvojë në këtë fushë. Të rinjtë kryesisht përdoren për fushata dhe tubime elektorale. Përkundër vullnetit të shumicës, ata mbesin jashtë proceseve e debatimit të politikave, pa qasje në vendimarrje, dhe me mundësi shumë të kufizuar pjesëmarrjeje në programet e avancimit dhe zhvillimit.

Hapësirën e dedikuar për të rinj dhe gra, partitë politike e reduktojnë në forume të ndryshme; respektivisht, në forumet rinore dhe ato të grave.¹ Forumet janë konceptuar si struktura që e lehtësojnë përfshirjen e të rinjve dhe grave në vendimarrje. Pjesa më e madhe e subjekteve politike kanë struktura të brendshme, të përcaktuara mirë dhe me shtrirje të gjerë gjeografike brenda vendit. Mirëpo, këto struktura të rrjetëzuara, bashkë me rregullat dhe procedurat e tyre të detajuara, nuk sigurojnë përfshirje të mirëfilltë të të rinjve në vendimarrje. Ata shpeshherë mbesin të marginalizuar shkak i moshës së tyre, mundësive të kufizuara dhe mungesës së përvojës.

Në shikim të parë, duket sikur përfaqësimi gjinor nëpër forume rinore nuk është problem. Pjesëmarrja e vajzave arrin diku mes 30- 40%.² Deri së fundmi njëri nga forumet udhëhiqej nga një vajzë; ndërkaq tani asnjë. Vajzat dhe gratë vazhdojnë të përballen me praktika diskriminuese brenda forumeve rinore dhe partive të tyre politike. Rrugëtimi dhe përfshirja e mëtutjeshme e vajzave dhe grave në politikë i nënshtrohen barrierave të kulturës patriarkale, gjë që jetësohet edhe brenda partive politike.

Çështjet, si mungesa e besimit, korrupsioni, shpërputhja e ideve dhe hapësira e kufizuar për një angazhim të mirëfilltë, ndikojnë në atë që një pjesë e madhe e të rinjve të jenë apatik ndaj politikës. Hulumtimet tregojnë se [73% e të rinjve asnjëherë](#)

¹ Lëvizja Vetëvendosje nuk ka forum rinor e as të gruas, me arsyetimin se brenda saj të gjithë janë të barabartë dhe të gjithë vlerësohen në bazë të kontributit brenda Lëvizjes.

² Grupi për Ballkanin, punëtori të zhvilluara në dhjetor 2017.

[nuk janë angazhuar në ndonjë parti politike, për shkak të mungesës së motivimit dhe hapësirës së kufizuar](#). Përkundër kësaj, një numër i kufizuar i të rinjve ([rreth 10%](#)) pjesëmarrjen në politikë e shohin si mundësi për ndryshime. Këtë mundësi ata kryesisht e shohin përmes angazhimit nëpër parti politike, përkatësisht në struktura rinore.

Gjatë vitit 2017, Grupi për Ballkan zhvilloi hulumtime dhe punëtori me anëtarët e forumeve rinore, me qëllimin që të kuptojnë proceset, sfidat, arsyet dhe problemet e inkuadrimin të tyre në politikë. Hulumtimi erdhi në përfundimin se nevoja për hapësirë dhe përkrahje të ideve, përkrahja dhe [preferencat ndaj personaliteteve të caktuara politike](#), mundësitë e perceptuara për të bërë ndryshime, përfaqësimi i zërit të tyre, gjendja e rëndë ekonomike e shoqërisë dhe edukimi, janë shkaqet kryesore për angazhim politik të të rinjve. *“Aktivizimi në forumet rinore është mënyra e vetme për të kontribuar në vendimarrjen reale dhe për ta ndryshuar gjendjen, sepse të ofron mundësinë për të qenë pjesë e proceseve të mëdha”*, u nënvizua, mes tjerash, nëpër punëtoritë e mbajtura me të rinjtë.

Shumica e tyre angazhimin nëpër forume rinore e shohin si të vetmen mundësi për angazhim në jetën publike të vendit. Mundësitë tjera mbeten tejte të kufizuara, përdërisa vetë kualifikimi i mangët i shumicës së tyre ua pamundëson marrjen me angazhimet më inovative të kohës.

Shumë të rinjë vlerësojnë se mundësia e përfshirjes në procese të vendimarrjes, ose konkretisht kandidimi në zgjedhje, është më real nëse je pjesë e forumeve rinore. Nga ana tjetër, për shumikënd, përfshirë këtu edhe të rinjtë e angazhuar në politikë, forumet rinore shërbejnë vetëm si ‘një biletë hyrëse’ për punësim në institucionet publike, veçanërisht në ato qeveritare.

Forumet rinore: çfarë ofrojnë dhe çfarë iu ofrohet

Margjinalizimi dhe periferizimi i të rinjve brenda partive politike është një faktor dekurajues, në aspektin e anëtarësimit të tyre nëpër forume rinore. Roli i këtyre strukturave rinore është simbolik, kryesisht për arsye se vendimet përfundimtare bien në duart e anëtarëve më të vjetër të partisë.

Përgjithësisht, të rinjtë nëpër këto forume paragjykojnë shkakun i moshës së tyre. Ata përjashtohen nga proceset e vendimarrjes dhe nga çështjet e rëndësishme të politikëbërjes lokale dhe nacionale. Kjo për faktin se të qenit i ri në mendësinë e partive politike nënkupton të jesh i papërvojë. Ka raste kur një mendësi e tillë

reflektohet edhe në zgjedhjen për kryetarë të strukturave rinore të personave më të moshuar se sa ajo e paraparë për anëtarësim.

Mosha e padefinuar e rinisë shpeshherë shkakton paqartësi rreth asaj se kush është i ri, e kush jo. Nëpër forumet rinore të partive politike nuk ekziston një uniformitet lidhur me moshën si kriter përcaktues për anëtarësimin “e të rinjve” në strukturat e tyre.³ Nuk ekziston një përkufizim i qartë nëse jetëgjatësia biologjike, apo ajo politike, e përcaktojnë termin e të qenit i ri në politikë.

Nëse ndokush nga shoqëria civile, mediat ose sferat e tjera publike, që shpeshherë sipas moshës i takon shumicës së anëtarëve të forumeve rinore, i bashkohet një partie politike, ai bëhet pjesë e strukturave kryesore të partisë. Ky nuk është rasti me një të ri tjetër, një student ose me një të sapo-diplomuar, që nuk është shumë i njohur. Nga të tillët kërkohet që fillimisht të anëtarësohen në forume rinore.

Priveligjimi dhe avancimi me automatizëm i “prurjeve të reja” po i dekurajon të rinjtë brenda subjekteve dhe ata potencialisht të interesuar që të anëtarësohen. Anëtarët e forumeve rinore këtë praktikë e shohin si të padrejtë karshi kontributit të tyre. Në prag të çdo procesi zgjedhor subjektet i inkuadrojnë figurat e rëndësishme publike, duke i anashkaluar kështu strukturat partiake. Ata, shpeshherë, prurjeve të reja iu referohen si “parashutistë”; kjo reflekton më së miri zhgënjimin e tyre ndaj mungesës së standardeve të anëtarësimit dhe avancimit partiak.

Roli i forumeve rinore përcaktohet nga vetë partitë politike. Varësia e tyre në çdo aspekt nga partitë (kryesia) amë bën që ndikimi i forumeve të jetë i kushtëzuar dhe i pakonsoliduar. Përfshirja e plotë e të rinjve në vendimmarrje mundësohet vetëm në çështjet që ekskluzivisht ndërlidhen me forume rinore. Përkundër kësaj, partitë politike i aprovojnë vetëm vendimet, gjegjësisht aktivitetet e propozuara në nivel të forumeve, që nuk ndikojnë në politikat e përgjithshme të partive. Rrjedhimisht, aktivitetet e forumeve rinore mbesin të kufizuara në çështje dhe aktivitete jorelevante. Këto aktivitete nënkuptojnë protestat dhe aksionet simbolike, aktivitetet e leximit, shfaqjen e filmave, organizimin e mbrëmjeve rinore dhe aktivitetet humanitare.

Mbështetja dhe promovimi i liderëve partiakë gjatë fushatave zgjedhore janë padyshim aktivitetet kryesor të të rinjve. Gjatë fushatave zgjedhore, anëtarët e forumeve rinore shfrytëzohen si shërbëtorë për mbajtje flamujsh dhe shpërndarje të

³ PDK moshën e anëtarësimit në forum rinor e ka të kufizuar nga 16 -25 vjet, Nisma nga 18 vjet, AKR deri në 30 vjet.

posterëve e fletushkave. Anëtarët më lojalë dhe me mundësi më të mëdha ndikimi në elektorat, si dhe për sigurim të votave, janë ata që favorizohen më tepër nga partia.

Nepotizmi dhe favoret politike janë fenomene të pranishme edhe në forumet rinore. Të rinjtë ankohen se edhe brenda forumeve "njoftësia" është katalizator i ngritjes në pozitë. Kjo gjë e kufizon hapësirën për mendim kritik, dhe e dekurajon angazhimin e mirëfilltë intelektual dhe arsimimin e të rinjve, sidomos në fushën e politikave publike.

Edhe forumet rinore kanë telashet e veta, të cilat me saktësi e reflektojnë mënyrën e funksionimit të gjithëmbarshtëm të subjektetit që i takojnë. Kryetarët, ose udhëheqesit e forumeve rinore, janë tejet të privilegjuar në raport me kolegët e tyre. Ata janë të vetmit që përfitojnë, që eventualisht bëhen pjesë e takimeve të subjekteve, marrin pjesë ose dërgohen në trajnime, dhe që kanë komunikim me partnerë brenda dhe jashtë subjekteve. Shumë anëtarë të forumeve ankohen se janë të kufizuar edhe nga vetë strukturat udhëheqëse të këtyre forumeve.

Hapësira e limituar për qasje kritike dhe pjesëmarrje në vendimarrje ka ndikuar në atë që forumet rinore të riprodhojnë mendësinë e partive të tyre politike, përderisa anëtarët të imitojnë liderët partiakë. Kjo, mes tjerash, reflektohet edhe në qasjen e tyre ndaj kundërshtarëve politikë. Raportet mes forumeve rinore, sikurse edhe ato mes vetë partive politike, janë shumë të polarizuara politikisht. Forumet janë të prirura që të bashkëpunojnë me forumet e partive me të cilat janë në koalicion. Këto janë partneritete të brishta, dhe si tendencë kanë shpërbërjen, menjëherë pas shpërbërjes se koalicioneve - pavarësisht aktiviteteve të përbashkëta që mund t'i kenë organizuar. Veç tjerash, kjo praktikë dëshmon për hezitimin e forumeve që të aplikojnë një qasje më gjithpërfshirëse dhe racionale, e cila pastaj do t'i sfidonte qëndrimet brenda partive të tyre.

Partitë kanë bërë fare pak - pothuajse asgjë - në zhvillimin dhe përgatitjen e kuadrit të tyre të rinjëve. Kontributin më të madh, ndonëse shumë më pak sesa në fushat tjera, e kanë dhënë organizatat joqeveritare dhe donatorët. Të rinjtë nëpër forume, që kanë përvetësuar pak më tepër njohuri, kanë kaluar nëpër programet e ndryshme të OJQ-ve vendore, fondacioneve dhe instituteve ndërkombetare. Megjithëkëtë, numri i tyre mbetet i vogël, ndëkohë që edhe ata pak të rinjë të trajnuar dështuan që këto njohuri t'i transmetonin tek kolegët e tyre.

Panelistët e [Konferencës së Grupit për Ballkanin për promovimin dhe fuqizimin e të rinjve në politikë](#) - përfaqësues e partive më të mëdha politike në Kosovë, që ishin identifikuar si politikanë modelë nga forumet e tyre rinore, si dhe përfaqësuesit e këtyre të fundit, konfirmuan sfidat me të cilat përballen të rinjtë në politikë.

Përveç ekzistimit të shumë sfidave, u tha se barrierat kryesore për rritjen e rolit të rinjve në politikë ndërlidhen me: 1) stereotipet karshi moshës së re, 2) aktivizmin e forumeve rinore, kryesisht gjatë fushatave politike, të diktuar nga partitë politike dhe liderët e lartë, 3) mungesën e hapësirës për qasje kritike dhe kontribut autentik. Krahas mungesës së njohurive, përvojës dhe qasjes, roli i të rinjve në proceset e vendimarrjes dhe hartimit të politikave në masë të madhe mbetet sipërfaqësor.

Edhe më shqetësues është fakti se forumet dhe strukturat rinore të subjekteve mbeten krijesa shumë pak të njohura nga vetë subjektet, për opinioin e gjërë, dhe grupet tjera të interesit, përfshirë këtu edhe donatorët. Shumica e forumeve nuk mund të gjinden në publik, nuk ekzistojnë adresa për to, nuk kanë uebfaqe aktive, e as struktura e organograme të qasshme.

Për ndryshimin e gjendjes, rritjen e rolit dhe pjesëmarrjes së të rinjve në politikëbërje dhe në subjektet politike:

Partitë politike duhet të bëjnë një definim më të saktë dhe të avancuar statutor të përfaqësimit të të rinjve brenda strukturave vendimarrëse, përmes rritjes rrënjësore të pjesëmarrjes së tyre.

Partitë politike duhet të hartojnë praktika për konsultime të rregullta me forumet rinore, lidhur me hartimin e politikave publike, funksionimin demokartik të subjekteve politike, proceset integruese, etj.

Subjektet politike duhet të mbajnë diskutime publike me strukturat e veta lidhur me programet dhe agjendat politike apo qeveritare.

Subjektet politike duhet t'i zhvillojnë programet e trajnimit dhe ato zhvillimore për strukturat e tyre rinore.

Donatorët duhet të konsiderojnë mbështetjen direkte për të rinjtë në politikë, të mbështesin programet zhvillimore të subjekteve – me kusht të rritjes së pjesëmarrjes së tyre dhe të zhvillimit demokratik të atyre subjekteve.

Forumet rinore duhet të krijojnë mekanizma për monitorim të pjesëmarrjes në subjektet e veta, në hartimin e politikave dhe për monitorimin e implementimit të politikave e programeve të subjekteve të veta, qoftë edhe duke bashkëpunuar me organizatat e pavarura joqeveritare dhe rinore.

Forumet rinore duhet të rrisin prezencën dhe dukshmërinë e tyre, të zhvillojnë aktivitete jashtë subjekteve politike, të rrisin praninë mediale, dhe të krijojnë marrëdhënie dhe qasje të vazhdueshme publike.

Ky artikull është mbështetur nga:

Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Agjencia Zvicerane për Bashkëpunim (SDC) dhe nga Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe i menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja e këtij artikulli është përgjegjësi e Grupit për Hulumtim të Politikave në Ballkan dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SDC-së, DANIDA-së apo KCSF-së.

Dhe

Ambasada e Mbretërisë së Norvegjisë



Norwegian Embassy

Grupi për Hulumtimin e Politikave në Ballkan (BPRG) është organizatë (Think Tank institute) e pavarur rajonale, me seli në Prishtinë, Kosovë. Ne ofrojmë analiza të detajuara të politikave zhvillimore për një sërë çështjesh të ndërlidhura me shtet-ndërtimin, konsolidimin institucional e demokratik; integrimin e minoriteteve, dhe marrëdhëniet ndërshtetërore; si dhe integrimin evropian dhe reformat politike.

Ne kemi dekada përvojë në hartim, raportim dhe zhvillim të politikave, qasje strategjike dhe avokim tek qeveritë, institucionet ndërkombëtare, si dhe organizatat joqeveritare.

Në thelbin e punës sonë qëndrojnë raportimet tona të sakta, të detajuara dhe të paanshme, gjithmonë të bazuara në hulumtimet tona nga terreni. Ne shkojmë përtej qëndrimeve të etabluara dhe synojmë të bëjmë ndryshime përmes rekomandimeve për politika për të ardhmen e që janë kreative, të realizueshme dhe të matshme, duke kontribuar që vendet tona të zhvillojnë shoqëri dhe shtete të fuqishme demokratike, të qëndrueshme dhe të suksesshme bazuar në sundimin e ligjit.

Grupi për Ballkan ka dizajnuar edhe instrumente të reja për të arritur këtë ndryshim, siç janë: Dialogu Politik, Forumi Politik (Forum për Avokim i nivelit të lartë i organizatave Think Tank) dhe Forumi i Shoqërisë Civile për Bashkëpunim Ndërkufitar.

Për më shumë, vizitoni ueb-faqen tonë www.balkansgroup.org ose, na kontaktoni në office@balkansgroup.org



Norwegian Embassy

Activity supported by the
Canada Fund for Local Initiatives
Activité réalisée avec l'appui du
Fonds canadien d'initiatives locales

Canada



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS OF DENMARK
DANIDA | INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION

www.balkansgroup.org